



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor
Nr: 04-353/01-58553
Dt. 02.06.2025
P r i z r e n

DREJTORATI PËR URBANIZËM DHE PLANIFIKIM HAPËSINOR KK – PRIZREN, me kërkesën **Autostrada Biennale** me seli në rrugën Qylani i Vjetër nr.11 Prizren ,e në bazë të neneve 3 alineja 1 pikat 1.1, 1.6, 1.7, 1.11, 1.17, 1.24 dhe të nenit 4 alineja 1 pika 1.2, e lidhur me nenin 5 alineja 1 pika 1.3 dhe 1.4 si dhe nenit 14 alineja 1 pika 1.4 dhe 1.5 si dhe ne lidhje me nenin 15 pika 1.1 dhe nenit 19 pika 2 të Ligjit për ndërtim nr. 04/L-110, dhe në harmoni me dipozitat e nenit 3 alineal pikat 1.1, 1.3, 1.5, 1.6, 1.7 dhe 1.8 e lidhur me nenet 4, 5, 9 dhe 11 të Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit nr. 04/L-066, nenit 2 paragrafi 2.2,2.10,2.16,2.19 dhe 2.20,nenit3,4 dhe nenit6 të Ligjit nr.02/L-88 për Trashëgimi Kulturore ,si dhe Vendimit për miratimin e Planit Rregullues Urban për Konservim dhe Zhvillim të Zonës Historike të Prizrenit-Zona e Parë e Mbrojtjes nr. 01/011 - 604 të dt. 18.12. 2008, nenit 85 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të neneve 21,22,44,46,47,48 e lidhur me nenin 86 dhe nenin 125 dhe 127 të LPPA-së , lëshon këtë:

A K T V E N D I M

I. LEJOHET: Autostrada Biennale në zhvillimin e punimeve **Intervenimi i përkohshëm, në ndërtesën e Shani Efendiut për ekspozitë ,e cila gjindet në rrugën “Teqja Halveti” nr. /** e locuar në ngastrën kadastrale nr. **P-71813068-02134-1** Z.K.Prizren posedim i P.SH.BASHKËSIA E BANESAVE – KK Prizren (në bazë të Marrëveshje Bashkëpunimi – Bashkëfinancim ndërmjet Komunes së Prizrenit, Fondacioit Allianz dhe Autosrada Biennale me nr.01-331/24 të dt.31.05.2024).

- II.** Gjatë renovimit nuk lejohet ndryshimi i gabaritit,lartësisë dhe etazhitetit aktual të ndërtesës
- III.** Dokumentacioni teknik : Projekti i realizuar dhe i përpiluar nga arkitekti ekspert në restaurimin e trashëgimisë kulturore Walter Krautler nga Austria.
- IV.** Investitori decidivisht duhet të përmbahet Rekomandimeve të Vendimit të Qendrës Rajonale për Trashëgimi Kulturore me nr.158/2 të datës 26.05.2025 dhe Rekomandimit të Këshillit për Trashëgimi Kulturore të datës 22.05.2025.
- V.** Ditën e fillimit të punimeve investitori është i obliguar që të lajmërojë inspektionin e ndërtimtarisë në afat prej 8 ditësh.dhe të njoftojë QRTK-Prizren 7 ditë para fillimit të punimeve

VI. Punimet duhet të realizohen nën asistimin dhe mbikëqyrjen periodike nga përfaqësues të QRTK-së-Prizren

VI. Ky aktvendim pushon të vlejë në rast se me punë nuk fillohet brenda afatit prej 12 (dymbëdhjetë) muajsh duke llogaritur nga dita e marrjes së të njëjtës.

A r s y e t i m

Nga dokumentacioni teknik si dhe të shtojcave tjera të prezantuara së bashku me kërkesë vërtetohet se:


Që me procedurën paraprake është kontrolluar dokumentacioni teknik nga ana e bashkëpunëtorëve profesional, të Komunës së Prizrenit.

Duke shqyrtuar kërkesën e investitorit si dhe në kuptim të dispozitave të Rregullores mbi rregullat dhe procedurat për ndërtimin e objekteve të KK Prizren, është konstatuar se janë plotësuar kushtet dhe parashtruesit të kërkesës **Autostrada Biennale** ipet leja për – **Intervenimi i përkohshëm, në ndërtesën e Shani Efendiut për ekspozitë, e cila gjindet në rrugën “Teqja Halveti” nr. / e locuar në ngastrën kadastrale nr. P-71813068-02134-1** Z.K.Prizren posedim i P.SH.BASHKËSIA E BANESAVE – KK Prizren.

Nga se u tha më lartë u murr aktvendimi si në dispozitiv.


KËSHILLA UDHËZUESE JURIDIKE: Kundër këtij Aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtës MMPHI-së në Prishtinë, përmes këtij organi.

Bashkëpunëtor profesional:



Xhejlane Gjini, inxhi. dip. ark.

Drejtori:



Pranverim Berisha, jur.

Shtojcë:

Vendimi i Q.R.T.K. nr.158/2 dt.26.05.2025

Rekomandim i K.T.K.Q.H.P. dt.22.05.2025